
**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“BPG ALBANIA” Sh.p.k.**

AKT- THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“BPG ALBANIA” Sh.p.k.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve themelues te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **“BPG ALBANIA” Sh.p.k.** dhe me emer tregtare **“BPG ALBANIA”**, zoterohet nga ortaket:

- 1. Z. RAN URI FRENKEL**, shtetas izraelit, lindur ne Jeruzalem, me 06/11/1973 dhe rezident ne, 16 Habrosh st. Savion, Israel, i identifikuar nga pashaporta me nr. 41631317.

Në përputhje me vullnetin tone te lirë dhe bazuar ne dispozitat e legjislacionit shqiptar, vendosem të hartojmë këtë akt themelimi të shoqërisë **“BPG ALBANIA” Sh.p.k.** mbi bazen e ketyre principeve:

NENI 1
FORMA DHE EMRI

Shoqëria ka formen e shoqërise me përgjegjësi të kufizuar, me initiale SH.P.K., dhe i perballon humbjet deri ne kufirin maksimal te vleres se kontributit te ortakeve ne kapitalin themeltar. Emri i shoqerise **“BPG ALBANIA” Sh.p.k.**

NENI 2
BAZA LIGJORE

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, Ligji me Nr.9901, datë 14.04.2008 në përputhje me legjislacionin shqiptar në përgjithësi, në përputhje me aktet e shoqërise si dhe në përputhje me marreveshjet nderkombetare te ratifikuara dhe qe do te ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërise.

NENI 3
SELIA

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Rruga e Kavajes, pasuria e ndodhur ne Zonen Kadastrale 8220, Nr. pasurie 6/266+1-25, hyrja 1, Apartamenti 25, Tirane, Albania. Në adresën e mesiperme do të identifikohet qendra e personit juridik.

Me vendim te asamblese, mund të hapen dege, filiale, agjensi ose perfaqësi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërise sipas fushave ne te cilat e ushtron veprimtarine shoqëria.

NENI 4

KOHEZGJATJA DHE PRISHJA E SHOQERISE

Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj për një afat të pa përcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit në organin kompetent. Shoqëria priset dhe kalon në procedure likuidimi, sipas rasteve të parashikuara me ligj.

NENI 5

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve të mëposhtme në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj :

1. Zhvillimi i sistemeve dhe aplikacioneve të sigurisë kibernetike, ofrimi i shërbimeve të monitorimit, testimit dhe mbrojtjes së rrjeteve kompjuterike, si dhe organizimi i programeve të trajnimit dhe ngritja e Akademise Kombëtare të Sigurisë Kibernetike.
2. Ofrimi i shërbimeve të mbështetjes teknike për kompani ndërkombëtare, përfshirë dizanji teknik (CAD), shërbime administrative dhe operacionale, rekrutim dhe menaxhim burimesh njerëzore, si dhe shërbime të tjera të natyrës konsulencë.
3. Zhvillimi i projekteve inovative në fushën e teknologjive satelitore, duke përfshirë projektimin, instalimin dhe mbështetjen teknike të stacioneve tokësore, sistemeve të komunikimit dhe monitorimit, si dhe zgjidhje të integruara për aplikime industriale dhe civile.
4. Projektimi, furnizimi dhe integrimi i dronëve dhe pajisjeve ajrore pa pilot, me qëllim përdorimi në fusha të ndryshme si monitorimi mjedisor, në sektorin e bujqësisë, në logjistike etj. Përfshin gjithashtu shërbime të specializuara për mirëmbajtje, trajnime dhe zhvillimin e teknologjive të reja për aplikime të qëndrueshme dhe inovative.

Shoqëria mund të ushtrojë çdo aktivitet tjetër tregtar, industrial, financiar, konsulence dhe shërbimesh, që nuk ndalohet me ligj, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 6

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërise është 100,000 Leke (nje qind mije Leke), i ndare në 1 (nje) pjese. Kapitali themeltar i shoqërise zoterohet nga:

- 1. Z. RAN URI FRENKEL**, shtetas izraelit, lindur ne Jeruzalem, me 06/11/1973 dhe rezident ne, 16 Habrosh st. Savion, Israel, i identifikuar nga pashaporta me nr. 41631317, i cili zoteron 1 (nje) kuote ne vleren 100,000 leke (njqindmije) e cila perfaqeson 100% te kuotave te kapitalit te shoqerise.

Kapitali themeltar i shoqërise do të shlyet tërësisht dhe depozitohet ne nje llogari të hapur në emër të shoqërise në një nga bankat e nivelit të dyte.

NENI 7

AKTET E SHOQERISE

Shoqeria do te rregullohet, pervec këtij akt-themelimi edhe me norma te percaktuara ne statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërise dhe si i tillë do të miratohet në ditën e regjistrimit si person juridik në Republikën e Shqipërise.

NENI 8

ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese të shoqërise do të jenë Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve dhe Administratori. Shoqëria mund të emëroj më shume se një administrator edhe pse nuk eshte ortak. Në çdo rast, kur termi “Administrator” përdoret për të përcaktuar administratorët e shoqërise **“BPG ALBANIA” Sh.p.k.**, ky term nënkupton të gjithë administratorët e saj sado qofshin këta në numer. Përveç organeve të parashikuara më sipër asambleja e ortakëve mund të krijojë edhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohezgjatja dhe kompetencat e tyre. Administrator i shoqërise për një periudhë 5 (pese) vjeçare, eshte emeruar:

Visar Hysi, te cilit i besohen te gjitha fuqite e administrimit te zakonshem dhe te jashtezakonshem dhe i identifikuar me pashaporte me Nr. ID. I60513083N.

NENI 9

DISPOZITAT E FUNDIT


Çdo mosmarrveshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likuidimin e kësaj shoqërie, ortakët do angazhohen se do të zhgjidhin me mirëkuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet kompetente për gjykimin e mosmarrveshjeve a konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqesorë Tirane.

Ky akt themelim është hartuar në 4 (kater) ekzemplare, 2 (dy) ne gjuhen shqipe dhe 2 (dy) ne gjuhen angleze duke patur secili ekzemplarë fuqi të njëjtë ligjore.

Tirane, 02.09.2025

**ORTAKU I VETEM I SHOQERISE
“BPG ALBANIA” Sh.p.k.**

RAN URI FRENKEL

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Ran' followed by a stylized flourish, is written over a solid horizontal line. Below the line, the name 'Frenkel' is written in a cursive script.